

VENDIM
Nr. 731, datë 3.12.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 35, DATË 27.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2021, NË
INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETËTËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT
CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 35, datë 27.1.2021, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 është, gjithsej, 889 (tetëqind e tetëdhjetë e nëntë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- | | |
|---|--------|
| a) për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues | 8; |
| b) për kategorinë e mesme drejtuese | 60; |
| c) për kategorinë e ulët drejtuese | 169; |
| ç) për kategorinë ekzekutive | 652.”. |

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj